



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Mars 2022

Nr: 134

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E REZULTATIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË
SHKODËR, QARKU SHKODËR, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR
BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022 DHE DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË
BASHKISË Z. BARDH ALI SPAHIA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, në bashkinë Shkodër, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie.

Pasi përfundoi procesi i dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi, për Kryetarin e Bashkisë Shkodër, nga të 4 KZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të nxjerrë rezultatit për këtë bashki, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 123, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr. 2, me vendimin nr. 495, datë 7.3.2022, KZAZ nr. 3, me vendimin nr. 207, datë 7.3.2022, KZAZ nr. 4, me vendimin nr. 245 , datë 7.3.2022 dhe KZAZ nr. 5, me vendimin nr. 203, datë 7.3.2022, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik dhe rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 3, KZAZ nr. 4 dhe KZAZ nr. 5, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ, me përjashtim të qendrave të votimit nr. 0092, nr. 0132 dhe nr. 0133, në ZAZ nr. 2 ku nuk u zhvilluan zgjedhje.
- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

QV me probleme	Problemi	GN	TPR	SISTEM
03081	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	165	156	156
03081	Fletë Votimi të gjetura në kuti	165	165	165

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, qarku Shkodër, me shifrat e korrigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuara nga Grupi i Numërimit të Votave.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të japë mandatin e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, z. Bardh Ali Spahia, të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 9 Mars 2022

Nr. 134

“Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, qarku Shkodër, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë z. Bardh Ali Spahia”



TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE



Për kandidatët për kryetar të bashkisë Shkodër

			Gjithsej
1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	46882
		gra	21941
2	Fletë votimi të papërdorura		112545
3	Fletë votimi të dëmtuara		119
4	Fletë Votimi të gjetura në kuti		46879
5	Vota të pavlefshme		800
6	Vota të vlefshme		46079

Nr	Kandidatët për Kryetar		Gjithsej
1	Majlinda Xhevdet Angoni	PS	18205
2	Bardh Ali Spahia	Sh-L	20125
3	Xhemal Esat Bushat	PD	7749
Gjithsej vota të vlefshme			46079